



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2598/Prot
2

Rrëshen, më 23 . 06 . 2026

V E N D I M

Nr. 49 datë 22. 06. 2026

PËR
“PËRDORIM FOND REZERVË - DHËNIE MBËSHTETJE FINANCIARE”,
BASHKIA MIRDITË

Në mbështetje të ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", në Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin nr. 2, datë 14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit 2026", VKB nr. 98, datë 10.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026", kërkesë me nr. 2598 prot. datë 10. 06. 2026, "Për mbështetje financiare" Kf. Mirdita U-11, Kf. Mirdita U-13, së bashku me projektin e Kryetarit Bashkisë, shqyrtimin e miratimin në mbledhjen e datës 19.06.2026, të Komisionit Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit, për t'a kaluar në seancën e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë, në shumën 200 000 (dyqind mijë) lekë, për dhënie ndihmë/mbështetje financiare, si vijon;
✚ T'i akordojë ndihmë/mbështetje financiare, Kf. Mirdita U-11 & Kf. Mirdita U-13
 - a. **Paksim:** Fond rezervë;(A1133 00 2133001 01 V491AAA...609) në vlerën; 200 000 lekë
 - b. **Shtohet:** Pagesë;(AA133 00 2133001 01 V111AAA...606) në vlerën;.....200 000 lekë
2. Pagesa të kryehet, në bazë të dokumenteve dhe faturave që vërtetojnë shpenzimet, në degën e Postës Mirditë, zyra Postare Rrëshen
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Mirditë, (Drejtoria e Financës dhe Buxhetit)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICA KU



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA MIRDITË

KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË

Nr. 2598 prot

Rreshen me 16 / 06 /2026

Nr. 62 date. 18.06 .2026

“PËR PERDORIM FOND REZERVE ”

Mbështetur në ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ne ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, 87/2025, “Per buxhetin e vitit 2026” “Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, në udhëzimin nr.2, datë.14.01.2026, “Për zbatimin e buxhetit 2026”, ,ne VKB nr.98 datë 10.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026”, në kërkesen , nr.2598 prot, datë.10.06.2026, “Ndihme financiare”, E stafit te KF Mirdite, këshilli i bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i bashkise;

V E N D O S I:

I-Të perdorë nga fondi Rezerve shumën 200 000 lekë, për dhënie ndihmë financiare si më poshte;

1.Të japë ndihmë financiare Klubit te Futbollit Mirdita

a-Paksim:fondi rezervë (AI133 00 2133001 01 V491AAA..609) për shumën 200 000 lekë

b-Shtohet (AA133 00 2133001 01 V111AAA.....606) për shumën 200 000 lekë

.2.Pagesa te kaloje ne degen e Postes Mirdite, zyra Postare Rreshen .

II-.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sektori e finances dhe buxhetit.

III-.Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Gaspër TOPOLLAJ

KRYETARI
Aleksander PICAKU

Paraqiten projektin

Dr./zhvill ek dhe tatim taksat:: V.Gjoka

Pergj sekt juridik: L..Gjergji



ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 222162223www.bashkiamirdite.gov.a

Vn. 2538/191

Dt. 10.06.26

KF MIRDITA



KERKESE

Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë Mirditë

Për dijeni: Këshillit Bashkiak Mirditë

I nderuar z. Kryetar,

Klubi i Futbollit Mirdita ka marrë ftesë për të marrë pjesë në turneun ndërkombëtar të përvitshëm **"Balkan Premises"**, i cili do të zhvillohet në Maqedoninë e Veriut nga data **21-24 qershor 2026**.

Në këtë aktivitet do të përfaqësohen grupmoshat **KF Mirdita U-11** dhe **KF Mirdita U-13**, me një pjesëmarrje totale prej **25 fëmijësh**.

Duke qenë se pjesëmarrja në këtë turne sjell kosto financiare për familjet e sportistëve të rinj, kërkojmë nga Bashkia Mirditë mbështetje financiare në vlerën deri në **200.000 lekë**, me qëllim lehtësimin, sado modest, të barrës ekonomike për fëmijët dhe familjet e tyre, duke u mundësuar atyre të përjetojnë këtë eksperiencë të rëndësishme sportive dhe edukative.

Gjithashtu, dëshirojmë t'ju rikujtojmë se në edicionin e kaluar të këtij turneu, ekipi ynë u shpall **kampion** me grupmoshën **U-15**, duke përfaqësuar me dinjitet Mirditën dhe sportin lokal.

Duke ju falënderuar paraprakisht për vëmendjen dhe mbështetjen tuaj, mbetemi në pritje të një përgjigjeje pozitive.

Me respekt,

Stafi i KF Mirdita

Elvis Lleshaj

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Elvis Lleshaj'.

Luison Kaçorri

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Luison Kaçorri'.

Orest Jaku

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Orest Jaku'.